

MJEKË TË GJITHË EVROPËS, BASHKOHUNI!

"Karta e Romës" ringjall shëndetësinë në BE

Mjekë nga vende të ndryshme të Evropës publikuan në korrik një manifest për zhvillimin e shëndetësisë në Evropë. **"Karta e Romës"** u bën thirrje vendeve anëtare të Bashkimit Evropian të investojnë në mënyrë strategjike në shëndetësi dhe parandalim.

Gjatë nënshkrimit të saj në kryeqytetin italian morën pjesë Federata Kombëtare e Urdhrit të Mjekëve Kirurgë dhe Stomatologë si edhe homologët e tyre nga Franca, Gjermania, Greqia, Portugalia dhe Spanja. Presidenti i Federatës së Urdhrit të Mjekëve të Romës, Filippo Anelli ka shkruar një artikull në gazetën *Avvenire* nga i cili po sjellim disa fragmente.

Ndër pikat e "Kartës së Romës" është propozimi për një "klauzolë të qëndrueshmërisë shëndetësore", e cila u mundëson shteteve anëtare të Bashkimit Evropian të caktojnë burime shtesë për parandalimin dhe menaxhimin e sëmundjeve kronike, pa shkelur parametrat.

Gjithashtu ftohen shtetet anëtare që të përfshijnë në planet e tyre buxhetore afatmesme programe investimesh në sektorin shëndetësor si dhe i kërkohet Komisionit Evropian të njohë rolin e shpenzimeve shëndetësore si investim strukturor.

Po ashtu mbështetet zgjerimi i programit EU4Health në mënyrë që burimet evropiane të plotësojnë ato kombëtare për të forcuar sistemet shëndetësore. Së fundmi i jepet vëmendje e veçantë parandalimit përmes programeve të kontrollit mjekësor dhe menaxhimit të sëmundjeve kronike.

Çdo euro e shpenzuar për shëndetësinë publike

gjeneron gati dy euro në vlerë prodhimi. Shpenzimet për shëndetësinë gjenerojnë kërkesë për sistemin e biznesit, Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), punësim cilësor, zhvillim dhe gjithashtu kohezion social. Prandaj investimi në shëndetësi është një mënyrë për të investuar në zhvillimin ekonomik dhe social. Dhe është edhe më e rëndësishme ta bëjmë këtë tani në këtë moment vendimtar nga pikëpamja e politikës ndërkombëtare dhe e vetë Shteteve. Skenat e luftës në Evropë, në Lindjen e Mesme dhe në botë kanë rindezur garën për armatim.

Ky kontekst ndërkombëtar dhe politikat e reja amerikane po i shtojnë gjithnjë e më shumë shtetet evropiane të rrisin shpenzimet për mbrojtjen.

Evropa për nga origjina dhe vokacioni i saj nuk është vetëm mbrojtje e kufijve fizikë, por është mbi të gjitha pohim i kufijve të identitetit, i atyre parimeve që e bëjnë atë një komunitet dhe që përfaqësojnë thelbin e saj të vërtetë.

Është një shoqëri ku të drejtat dhe mirëqenia sociale janë elementë përbërës të Bashkimit. Veçanërisht shëndeti konsiderohet një e drejtë themelore.

Qytetarëve evropianë dhe çdo individ në Evropë u njihet e drejta për mbrojtjen e shëndetit si person dhe kjo njohje është kthyer në një tipar të Bashkimit tonë Evropian dhe një shenjë e madhe e zhvillimit civil dhe shoqëror.

Shqipëria një vend kandidat për anëtarësim në BE si duhet të pozicionohet ndaj këtij propozimi që u drejtohet të gjitha vendeve evropiane?

10 VJET ARKITEKTURË NË UKZKM

Krenarë për rezultatet



Në 10 vjetorin e themelimit të Programit të Studimit Arkitekturë në UKZKM Fakulteti i Shkencave të Aplikuara organizoi disa takime që tregojnë arritjet tona në një dekadë. Arkitektura është pasaporta shoqërore e një vendi dhe ne në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” i kemi kushtuar 10 vite përkushtim që pasqyrohet në programin tonë të studimit, profesionalizmin evropian të trupës tonë akademike dhe suksesin e të diplomuarve gjatë një dekade.

Gjithashtu Fakulteti i Shkencave të Aplikuara promovoi me këtë rast edhe Talks@UNIZKM_2025 një cikël konferencash ndërkombëtare të dedikuara arkitekturës italiane bashkëkohore me synim nxitjen e një debati kritik dhe ndërdisiplinor.

Ky ishte takimi i tretë në këtë format dhe bashkoi arkitektë dhe profesorë të Universitetit “La Sapienza” të Romës, Prof. Ark. Pisana Posocco dhe Prof. Ark. Filippo Lambertucci, të cilët referuan në konferencën me titullin “Hapësira për shenjtërinë”. UKZKM e kremtoi këtë dekadë të parë suksesi edhe me festime në kampusin universitar në UKZKM ku trokitëm gotat për këtë gur kilometrik tek i cili po ndalojmë krenarë duke hedhur sytë nga e ardhmja.



SHQIPËRIA MBRON TRASHËGIMINË ME INOVACION

Në Tiranë,
teknologjia dhe
kërkimi bashkohen
për mbrojtjen e
artit

Për trashëgiminë historike dhe kulturore të Shqipërisë është një ditë premtuese sepse në një nga godinat më të bukura dhe historike të Tiranës, siç është Salla e Koncerteve në Universitetin e Arteve, është zbatuar projekti inovator i monitorimit me një sistem të teknologjisë më të përparuar. Për herë të parë në Shqipëri Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” sjell



qeveritare, me Universitetin e Firences, me sipërmarrjen siç është Tecnapolo d'Abruzzo dhe me partnerët teknikë si Palmerini SCT, Èest Aquila Srl, Comitech Srl dhe MGAD Design. Kjo ngjarje mbledhi në Sallën e Madhe të Koncerteve në Universitetin e Arteve drejtues dhe përfaqësues të universiteteve, ministrive të linjës, deputetë të parlamentit evropian, arkitektë, diplomatë, studentë dhe të ftuar të tjerë.

Ngjarja me titull “Monitorimi Struktural i Teatrit të Akademisë së Arteve Tiranë: Teknologji Inovative për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Shqiptare” u prezantua me disa panele gjatë të cilave folësit sollën vlerësime, ide, njohuri dhe përvoja të vrya. I moderuar nga koordinatori i projektit PhD. Ark. Andia Guga takimi masiv ngjalli interes në secilën prej pjesëve të planifikuara.

një iniciativë që mbështet dhe mbron trashëgiminë e vendit në bashkëpunim të ngushtë me institucionet

Fillimisht Presidenti i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë fr. Ruggero Valentini pasi falenderoi miqtë dhe të ftuarit

e shumtë që u bënë pjesë e prezantimit të këtij projekti, bëri një panoramë të aktiviteteve të Fondacionit ZKM në Shqipëri që prej ditës së parë pas viteve '90, duke hedhur vështrimin tek ky projekt që tregon qartë dimensionin evropian dhe akademik të UKZKM dhe aftësitë e burimeve të tij njerëzore që janë prej disa dekadash pjesë e zhvillimit në Shqipëri. Presidenti përgëzoi të gjithë ata që kontribuan në këtë projekt ambicioz që do të monitorojë për dy vjet strukturën e sallës së madhe të koncerteve të Universitetit të Arteve.



Vetë Rektori i UA Erald Bakalli vlerësoi zbatimin e kësaj iniciative në këtë universitet që përfaqëson shpirtin krijues dhe historinë kulturore të Shqipërisë. Duke sjellë në rrjeshtat e parë të përshëndetjes së tij urimet për projektin Zv. Rektori i UKZKM Prof. Edmond Hajdëri tha se kjo ngjarje është shumë e rëndësishme për UKZKM në disa këndvështrime. Projekti jo vetëm ruan trashëgiminë historike dhe kulturore por po ashtu bashkon për herë të parë me sukses në partneritet modern institucionet shtetërore, botën akademike dhe botën e sipërmarrjes. Ky bashkëpunim, tha Z. Hajdëri, është në vazhden e planit të zhvillimit akademik që është rritur në mënyrë graduale vit pas viti në UKZKM duke përfaqësuar një model ekselence të bashkëpunimit edhe mes Shqipërisë dhe Italisë.

Deputeti italian Luciano D'Alfonso që erdhi nga Italia enkas për këtë ngjarje sa kulturore aq edhe shkencore tha gjatë aktivitetit sesi teknika përparon dhe sesi legjisllacioni mund të vijë në ndihmë që t'i bëjë të prekshme projekte të tilla duke përgëzuar Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" për këtë arritje që kontribuon sipas tij në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike të Shqipërisë.

Ndërsa Sekretari i Parë për Shkollat dhe Universitetet

në Ambasadën Italiane në Tiranë Sergio Alias tha se ishte i mbresuar nga ky projekt monitorimi që zbatohet jo vetëm për herë të parë në Shqipëri. Diplomati italian tha se bashkë me këtë ngjarje duhet theksuar edhe fakti se kjo iniciativë vjen nga universiteti UKZKM që shënon një histori suksesi duke përdorur teknologjinë në këtë bashkëpunim disa palësh. Takimi u përshëndet edhe nga Zv. Ministria e Arsimit Prf. Dr. Ana Kapaj e cila solli në fjalën e saj gjithë mbështetjen dhe vëmendjen që qeveria shqiptare tregon për rritjen e nivelit të kërkimit shkencor në universitetet e vendit. Teatri i Akademisë u projektua në vitet '30 të shekullit të kaluar nga arkitekti fiorentin Gherardo Bosio. Mbrojtja dhe ruajtja e kësaj godine kërkon një qasje shkencore, teknologjike dhe multidisiplinare ndaj iniciativa e prezantuar në këtë takim bashkoi kaq shumë pjesëmarrës. Në godinë është instaluar një sistem i monitorimit strukturor i quajtur SHM Board, me teknologji të përparuar të zbulimit, analizës dhe parandalimit të riskut.

Kjo nismë kërkimore dhe zhvillimore me kohëzgjatje 24-mujore është bashkëfinancuar nga AKKSHI (Agjencia Kombëtare për Kërkim Shkencor dhe Inovacion në Shqipëri) dhe Tecnopolo d'Abruzzo.

Duke përdorur sensorë të fjalës së fundit të teknologjisë dhe algoritme inteligjente të patentuara për të parandaluar alarmet false, sistemi i instaluar do të jetë në gjendje të zbulojë çdo shenjë të stresit strukturor,



dridhjeve anormale ose përkeqësimit progresiv të ndërtesës në kohë reale.

Kjo do të lejojë jo vetëm ndërhyrjen në kohë, por edhe zhvillimin e një protokolli parashikues mirëmbajtjeje që mund të aplikohet për ndërtesa të tjera historike të Shqipërisë.

Të dhënat e mbledhura do t'u vihen në dispozicion komunitetit akademik dhe shkencor, si dhe institucioneve lokale dhe profesionistëve të fushës. Qëllimi i projektuesve të kësaj iniciative është të nxisin një kulturë të re parandalimi ku teknologjia nuk zëvendëson ndjeshmërinë ndaj trashëgimisë, por përkundrazi e rrit atë me mjete konkrete.

MES PËRVOJAVE DHE HISTORIVE PERSONALE

Studentët e UKZKM

Pasi ndoqën shkollën e verës në Alto Adige tre studentët e UKZKM Jonida, Claudia dhe Desardi dërguan një mesazh falenderimi për përvojën e shkëlqyer që kaluan në Itali. Summer School në Alto Adige tregojnë të rinjtë i kaloi pritshmëritë e tyre duke filluar me pritjen në Castel Coldrano. Summer School u zhvillua në një kështjellë të vendosur në kodrinat e një fshati malor e piktoresk si Alto Adige dhe kjo u kthye në një përvojë edhe kulturore për të rinjtë tanë.

Studentët vlerësuan leksionet dhe praktikatat që u mentoruan nga mjekë të njohur të spitaleve në Alto Adige, madje u mbresuan nga fakti se trajnimi i tyre u krye me një përkushtim cilësor nga stafi i përzgjedhur.

Ndërsa e kalonin ditën mes leksioneve dhe praktikave mësimore, në mbrëmje i priste koha e lirë që e ndanë mes aktiviteteve sociale dhe kulturore. Përveç anës akademike, ata përjetuan edhe një ndjenjë të fortë bashkëpunimi dhe miqësie që do t'i shoqërojë edhe pas përfundimit të shkollës së verës.



Ekspierienca në këtë vizitë, tregojnë tre studentët tanë, do të mbetet gjatë në kujtesën e tyre, të cilën e pasuruan edhe me njohje të reja me studentë të mjekësisë pjesëmarrës në këtë shkëmbim akademik që ishin nga Italia, Austria dhe Gjermania. Sikur të rikthehesha pas, thotë njëri prej tyre, do zgjidhja ta jetoja edhe njëherë këtë përvojë.

KOHA PËR GJIRIN!

Projekti kombëtar promovohet nga UKZKM



Në Sallën e Senatit të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" u zhvillua promovimi i projektit kombëtar "Koha për Gjirin – Vlerësimi i personalizuar i rrezikut dhe diagnoza e hershme e kancerit të gjirit në farmaci", një nismë inovative në fushën e shëndetit publik.

Projekti synon të ndërgjegjësojë duke ndihmuar në parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm të rasteve përmes farmaceutikave pjesëmarrëse në këtë projekt.

Çdo grua do të ketë mundësi të plotësojë një pyetësor të vlerësuar shkencërisht, të marrë një vlerësim të personalizuar e konfidencial dhe nëse rezulton me risk



të lartë të përfitojë një telekonsultë me profesionistë të fushës për përcaktimin e kontrolleve të nevojshme. Faza pilot e këtij projekti përfshin 15 farmaci të përzgjedhura në Shqipëri gjatë të cilës farmacistët e trajnuar do të ndihmojnë në informimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit mbi shëndetin e gjirit.

Ky model synon të forcojë diagnostikimin e hershëm, të fuqizojë gratë dhe të krijojë një kulturë të re të parandalimit në të gjithë shoqërinë.

Ky projekt është inovativ dhe zhvillohet mes UKZKM dhe Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë me mbështetjen e Institutit të Shëndetit Publik (ISHP).

Vlerësimi do të jetë individual duke respektuar privatësinë dhe mbështetet në faktorë kyçë si historia familjare, faktorët hormonalë dhe riprodhues, stili i jetesës (p.sh. dieta, aktiviteti fizik, BMI), faktorët prediktivë

të kombinuar të llogaritur përmes algoritmeve të vlerësuar klinikisht.

Objektivat e projektit janë mbrojtja e shëndetit të grave, ndihmesa e specializuar për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit dhe reduktimi i barrës së sëmundjes në nivel kombëtar dhe rajonal.

Në takim dhanë vlerësimet e tyre Rektori i UKZKM Prof. Leonardo Palombi, Presidenti i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë fr. Ruggero Valentini, Drejtori i Spitalit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" Fabian Cenko, mjekë të njohur, farmacistë dhe përfaqësues nga Instituti i Shëndetit Publik.

Koha për gjirin është tani!



NJË INSTITUCION SHËNDETËSOR QË E BESOJMË

Fuqia e solidaritetit në shëndetësi.

Që nga fillimi i viteve '90 Fondacioni ZKM ka besuar në ndërtimin e një spitali të ri në Tiranë falë nxitjes konkrete të qeverisë shqiptare dhe inkurajimit të Nënë Terezës. Sot struktura është realitet dhe funksionon duke qenë besnike ndaj karakteristikave të saj si spital universitar, si organizatë jo fitimprurëse, me frymëzim të krishterë, si subjekt privat-shoqëror në shërbim të publikut. Ka shumë për të thënë në këto pak fjali. Imazhi është tashmë i qartë. Gjatë viteve janë firmosur marrëveshje që spitali të mbështetej edhe nga shteti. Këto angazhime ende nuk janë realizuar plotësisht. Megjithatë sot janë vetë njerëzit që e mbështesin Fondacionin për ta bërë këtë nismë të qëndrueshme.

Çdokush mund të kontribuojë, edhe thjesht duke kryer analiza klinike apo një radiografi në Spital. Kush paguan e kupton se të gjitha të ardhurat shkojnë për zhvillimin teknologjik dhe profesional të strukturës. Me fjalë të tjera: janë vetë njerëzit që investojnë në zhvillimin e Spitalit ZKM, sepse është një "e mirë e përbashkët".

NJË TEKNIK ME ZEMËR NË DORË

Në kujtim
të Orlando Saibene

Shprehja "Milano me zemër në dorë" i referohet aftësisë për të dhuruar dhe hapjes progresive mbi të cilat kryeqyteti i Rajonit të Lombardisë e ka ndërtuar zhvillimin e vet. Një tipar që tregon qëndrimin pozitiv edhe ndaj të tjerëve. Për këtë arsye Fondacioni ZKM nuk mund të harrojë një person si Orlando Saibene sipërmarrës ndërtimi nga Saronno, pak kilometra larg Milanos. Për vite me radhë ai qëndroi në Tiranë kur ndërtohej spitali i ri katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" për të dhënë kontributin e tij personal përmes ideve dhe kompetencave. Shumë njerëz e kujtojnë me dashuri dhe respekt për aftësinë e tij për të krijuar sinergji për të zgjidhur problemet dhe për të krijuar një klimë bashkëpunimi. Orlando u nda nga jeta në vjeshtën e vitit 2023.



21 shtatorin e kaluar e kujtuam dhe e falënderuam për përkushtimin dhe bujarinë e tij. Në Saronno gjatë një aktiviteti përkujtimor me rastin e dyqind vjetorit të lindjes së Atë Montit Presidenti i Fondacionit i dorëzoi bashkëshortes së tij, Lucia dhe djalit Andrea një pllakë me një thënie të Nënë Terezës, me lutjen e saj për "të gjithë ata që do të ndihmojnë në çfarëdo mënyre Spitalin "Zoja e Këshillit të Mirë në Tiranë". Dhe Orlandon sot e kujtojmë me nderim dhe mirënjohje si një prej atyre që e dha ndihmën e tij.

ARGËTIM DHE KUJDES NË KLINIKËN DENTARE "ZKM"

Buzëqeshja e shëndetshme



Më 26 shtator 2025 Klinika Dentare "Zoja e Këshillit të Mirë" organizoi aktivitetin për fëmijë "Aventurat e një Buzëqeshjeje të Shëndetshme".

Gjatë aktivitetit fëmijët takuan dentistin, vizituan klinikën dhe morën mësim dhe këshilla të vlefshme për kujdesin e duhur dentar.

Nuk është hera e parë që Klinika jonë vizitohet nga të vegjlit që kanë gjithë vëmendjen e stafit të UKZKM për të ndërtuar së brendshmi një kulturë kujdesi personal dhe sidomos për higjienën dentare. Aktiviteti u organizua si një orë loje ku nuk munguan dhuratat dhe surprizat e këndshme.

Departamenti i Pedodoncisë i udhëhequr nga Dr. Ada Caka një dentiste e specializuar në këtë fushë u dha fëmijëve dhe prindërve të gjithë informacionin që u nevojitet për kujdesin e shëndetit oral dhe parandalimin e zakoneve të këqija që dëmtojnë dhëmbët e fëmijëve.

Falë profesionalizmit dhe mbështetjes së stafit Klinika Dentare " Zoja e Këshillit të Mirë " është bërë një pikë referimi për prindërit që kërkojnë zgjidhje efektive për shëndetin oral të fëmijëve të tyre.

INFERMIERI MË I MIRË ËSHTË FILIPINEZ




Në botën e sotme nuk ka (ose nuk duhet të ketë) kufij ndarës, por kufij që veprojnë si pika hyrjeje. Dhe rasti është në Itali ku çmimi prestigjioz “Nursing Now Italy Award” i është dhënë një infermierit me origjinë nga Filipinet. Quhet Edilberto Cipres dhe punon në spitalin e Saronno-s (Lombardi).

Edi – thonë në spital – mishëron në mënyrë të përsosur disa nga cilësitë që secili pret të gjejë te një profesionist që punon në pavijon: është njerëzor, i sjellshëm, profesionist, shumë pozitiv dhe i hapur ndaj të tjerëve. Pa harruar që mund të përkufizohet si një shembull i integritetit kulturor.

Ai ka punuar më parë në Hamburg (Gjermani), por pavarësisht rrethanave më të favorshme ekonomike atje, vendosi të rikthehej në Itali duke thënë se: “këtu ndjehem si në shtëpi. Më pëlqen ushqimi, kultura dhe atmosfera që përjetoj çdo ditë”. Ky çmim jepet çdo vit nga CNAI (Konsorciumi Kombëtar i Shoqatave të Infermierëve). I urojmë karrierë të mbarë!

ZKM PRESS BOTON BIOGRAFINË NË ANGLISHT

I Lumi Luigi Monti



Në shtator me rastin e dyqind vjetorit të lindjes së Atë Montit ZKM PRESS botoi biografinë e të Lumit nga Igino Giordani. Bëhet fjalë për një ribotim të ri të edicionit në gjuhën angleze i publikuar në vitin 1998 nga “New City” në Londër. Giordani është një autor prestigjioz dhe njihet edhe si një nga baballarët e Kushtetutës italiane pas Luftës së Dytë Botërore dhe një shkrimtar i teksteve mbi doktrinën sociale të Kishës dhe shumë biografi të tjera.

Në jetën e tij ai ka bashkëpunuar ngushtë me Chiara Lubich në themelimin e Lëvizjes Fokolare.

Vepra titullohet “Një apostull i bamirësisë” dhe është botuar gjithashtu në italisht, frëngjisht, spanjisht dhe shqip.

Vëllimi është i disponueshëm në Bibliotekën e Universitetit “Fratel Paolo Ruatti” pranë UKZKM me një çmim prej 500 lekësh. Me këtë botim inaugurojmë aktivitetin e shtëpisë së re botuese të Universitetit “Zoja e Këshillit të Mirë”: ZKM PRESS.

RRJETET SOCIALE DHE REZISTENCA CIVILE

Mjekët e ardhshëm mund të përdorin ChatGPT për të kaluar provimet e mjekësisë ndaj do të ishte mirë të filloje të haje shëndetshëm

më pak transparente si për shembull në provime ose në përgatitjen e tezave universitare. Teknologjitë po ecin më shpejt se aftësia jonë për t'i zotëruar ato.

Në njëfarë mënyre përballë tyre jemi gjithmonë prapa. Pas shumë dekadash vetëm tani po ndjejmë nevojën për "etikë" për të mos shqetësuar të tjerët ose për të mos rënë vetë në një varësi të re.

Pasojat e vërshimit të mediave sociale janë të dukshme duke marrë parasysh injorancën e përhapur në fusha si gjeografia dhe historia ose epideminë e sindromës "Hikkikomori" që mbyll shumë adoleshentë dhe të rinj në dhomat e veta të izoluar nga bota.

Një rezistencë e shëndetshme është bërë thelbësore: por çfarë është rezistenca



Teknologjitë e reja të informacionit mund t'i krahasojmë me barërat e këqija: ato përhapen, lëshojnë rrënjë dhe mbysin barërat e tjera. Për ne është e vështirë të veprojme si Shën Françesku i Asizit, i cili me mirësi i kërkonte barishtet e padëshiruara që të mblidheshin të gjitha në një cep të kopshtit dhe të mos lëviznin prej aty. Sot teknologjitë e informacionit (IT) janë aq të përhapura sa na shtojnë të neglizhojmë alternativat, si për shembull të lexojmë libra apo të marrim pjesë në konferenca dhe takime. Siç e dimë mirë përveç qëllimeve më pozitive dhe interesante këto teknologji përdoren edhe për qëllime

ALARM I MATTARELLËS MBI KLIMËN E PAKËNAQËSISË

Historia e Ulli Monteiros

Urrejtja sjell më shumë urrejtje dhe dhuna më shumë dhunë. Jemi këtu sepse nuk duam të harrojmë, sepse nuk duam të jemi indiferentë ndaj këtij tmerri.» Kur Presidenti i Republikës së Italisë Sergio Mattarella tha këto fjalë në kujtim të Willy Monteiro Duarte, 21-vjeçarit të vrarë me shqelma dhe grushte pesë vite më parë për shkak se mbrojti një shok, i gjithë emocioni i mbledhur në sheshin Collesferro shpërtheu në një duartrokasje të madhe e të pafundme, veçanërisht nga të paktën tre mijë të rinjtë e pranishëm.

Aty kishte fëmijë të shkollave fillore që brohorisnin me flamujt trengjyrësh, por edhe shumë bashkëmoshatarë të Willy-t, studentë dhe jo vetëm, të cilët kishin ardhur nga e gjithë zona për të marrë pjesë në përkujtim ku ishte dhe Kreu i Shtetit. Dhe janë pikërisht të rinjtë, por edhe të rriturit, të cilëve u drejtohet Mattarella:



Të rinjtë meritojnë më shumë respekt dhe kërkojnë vëmendje të madhe. Duhet t'u ofrojmë atyre një horizont shprese. Duhet t'u kujtojmë atyre dhe të rriturve, dhe sidomos të rriturve, se dhuna nuk tregon forcë, por dobësi. Kushdo që beson se mund të afirmohet përmes dhunës, është i destinuar të dështojë. Një njeri i madh si Martin Luther King përsëriste se urrejtja shumëfishon urrejtjen dhe dhuna shumëfishon dhunën. Njerëzimi gjithmonë i ka lavdëruar ata që me veprimet e tyre kanë përhapur qytetarinë dhe ndër ta është edhe Willy.» Edhe pse pa e thënë haptazi Mattarella duket se i referohet disa ngjarjeve të fundit: «Gjatë historisë dhuna është shfaqur në forma të ndryshme. Duhet ta shikojmë dhunën e periudhës sonë në mënyrë që ta luftojmë, ta mposhtim.

Në shoqërinë e sotme po rikthehet përhapja e një klime kundërshtimi, pakënaqësie dhe refuzimi të ndërsjellë që siç shihet shpesh edhe nënngjarjet e fundit, çon në dhunë dhe arrin deri edhe në vrasje.» Prandaj, kundër çdo forme të urrejtjes është mesazhi që jep Mattarella nga Colleferro, duke përfshirë edhe atë që shfaqet në rrjetet sociale, ku «përforcohen fjalët e urrejtjes, të shoqëruara nga një narrativë që synon të gjenerojë mosbesim, të nxisë konflikte, përçarje dhe përplasje.

Hidhen poshtë realiteti, respekti për mendimin e tjetrit dhe kritika qytetare. Ai që është ndryshe nga vetja shihet si armik, një armik që duhet luftuar dhe mposhtur. Në vend të konsiderohet mendimi ndryshe si një sfidë për thellim, besohet se të tjerët duhet të asgjësohen.

Ekziston rreziku që dhuna të bëhet e zakonshme dhe banale, dhe për disa madje mund të jetë një burim krenarie.

Dhe pikërisht përkujtimi i Willy-t mund dhe duhet të veprojë si një mburojë ndaj urrejtjes dhe dhunës, thekson Mattarella, ndërsa miqve të tij u mbushen sytë me lot. Miqtë e tij kanë ardhur nga Paliano (Frosinone) ku ai jetonte me familjen e tij. Pavarësisht se me origjinë ishte nga Kepi i Gjelbër familja ishte tërësisht e integruar, aq sa djali luante në ekipin e vogël të futbollit në qytezën e tij. Nuk largohej kurrë kur duhej dhënë ndihmë apo mbështetje në aktivitete locale, që nga fushatat e



veprimtarive kishtare deri te rikrijimet historike me kostume.

«Willy është një italian shembullor dhe për këtë arsye është dekoruar pas vdekjes me Medaljen e Artë për Trimëri Civile, në njohje të aktit të tij të guximit dhe altruizmit. Për të shkon kujtimi dhe dhimbja e të gjithë italianëve, të plagosur nga një tmerr i tillë.

Të mos harrosh do të thotë të mos jesh indiferent. Indiferenca është po aq negative dhe e përcmueshme sa vetë dhuna. Indiferenca lind nga mbyllja në vetvete, nga mosbesimi, nga dorëzimi. Dhuna mund të mposhtet me solidaritet, me marrëdhënie njerëzore, me përfshirje, me dialog, me mirëkuptimin e mendimeve dhe nevojave të të tjerëve», tha Presidenti.

Mattarella, i pritur nga kryetari i bashkisë Pierluigi Sanna takoi nënën dhe motrën e Willy-t para ceremonisë zyrtare përkujtimore: «Në dhimbjen tonë të madhe ndjemë përqafimin dhe ngushëllimin e gjithë Italisë – tha ndër të tjera Lucia Monteiro Duarte duke falënderuar Presidentin e Republikës. Willy të mos kujtohet si hero, por si një djalë i thjeshtë dhe mik i të gjithëve.

Mesazhi ynë, ai që po përcjellim prej pesë vitesh është të jetosh jetën me paqe në zemër, pa urrejtje. Sepse urrejtja dhe hakmarrja sjellin gjithmonë dhimbje të reja dhe na pengojnë të shohim gjërat e bukura.



JO!

MIKROKREDITË SI BURIM

Nevoja për njohje të mikrokredive dhe financave etike

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” ka kënaqësinë të njoftojë hapjen e Modulit Jean Monnet – MAISCO EU, një projekt trevjeçar i financuar nga programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian, i cili do të promovojë mikrokreditin dhe financat etike si instrumente kryesore për përfshirje sociale dhe zhvillim të qëndrueshëm në Shqipëri. Mikrokredia është bërë një nga mjetet qendrore të politikave të BE-së për të luftuar përjashtimin financiar, për të mbështetur sipërmarrjen dhe për të fuqizuar grupet vulnerabël. Megjithatë, në Shqipëri varfëria mbetet e përhapur dhe shumë sipërmarrës të rinj nuk kanë akses në sistemet tradicionale financiare.

MAISCO-EU synon të mbushë këtë boshllëk përmes futjes së një kurrikule të re akademike mbi mikrokreditin, si dhe me leksione publike, nisma kërkimore dhe aktivitete përfshirjeje të aktorëve shoqërorë. Projekti do të ndërthurë mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin me komunitetin, duke përfshirë studentë, politikbërës, ndërmarrjeje të vogla dhe të mesme, OJQ dhe institucione lokale. Aktivitetet e planifikuara për tre vitet e ardhshme janë të larmishme dhe gjithëpërfshirëse. Çdo vit akademik do të zhvillohet një program 15-javor me leksione dhe seminare në gjuhën italiane dhe angleze, duke ofruar një mjedis dinamik të të nxënësve, të pasuruar me punë në grup dhe ese mbi politikën e BE-së për mikrokreditin. Përveç mësimdhënies në klasë, projekti do të organizojë leksione të hapura çdo vit, duke ftuar ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të ndarë përvojat e tyre me studentët, politikbërësit, bizneset, OJQ-të dhe publikun e gjerë.

Këto evente do të shërbejnë si hapësira të rëndësishme për debat dhe shkëmbim idesh. “MAISCO-EU është më shumë se një kurs: është një urë mes edukimit, politikës dhe shoqërisë,” – u shpreh Koordinator i Projektit, Prof. Emiljan Karma. “Duke integruar mikrokreditin në debatin akademik dhe qytetar në Shqipëri, synojmë të forcojmë kohezionin social dhe ta afrojmë vendin më pranë standardeve evropiane të zhvillimit gjithëpërfshirës.” Moduli do të zgjasë nga Tetori 2025 deri në Shtator 2028, me leksione vjetore, debate të hapura dhe konferenca me dëshirën e mirë që të kontribuojnë sadopak në rrugëtimin e Shqipërisë drejt integritimit në BE.



Jean Monnet Module
MAISCO-EU
ERASMUS+ PROGRAMME

INTERNATIONAL CONFERENCE

MICROCREDIT:
AN INSTRUMENT
OF SOCIAL COHESION

December 2, 2025
09:00
Aula Magna
CATHOLIC UNIVERSITY
OUR LADY OF GOOD COUNSEL
Tirana-Albania

NJË URË AKADEMIKE MIDIS TIRANËS DHE PESKARËS

Eksperienca në Erasmus+ e Ark. Franc Shllakut

Nga 1 deri më 6 shtator 2025, Arch. Franc Shllaku, Koordinator i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara në Universitetin tonë, mori pjesë në një mobilitet Erasmus+ KA171 për trajnim në Universitetin “G. d’Annunzio”



të Chieti-Peskarës. Pjesëmarrja e tij u zhvillua gjatë Staff Training Week të Departamentit të Arkitekturës në Peskarë, në kuadër të Summer School "On the Edge: Designing Pescara's Riverside". Gjatë javës së trajnimit, Arch. Shllaku mori pjesë në seminare, workshop-e projektimi, vizita në terren dhe takime me studentë dhe pedagogë ndërkombëtarë.



Përfshirja e tij në aktivitetet e mentorimit dhe rishikimet ndërmjetëse përfaqësoi një mundësi të çmuar për të kontribuar në punë dhe për të pasuruar rrugëtimin profesional përmes shkëmbimit të praktikave dhe metodologjive didaktike inovative.

Ky mobilitet për trajnim jo vetëm që forcoi aftësitë individuale dhe dialogun akademik, por gjithashtu konsolidoi bashkëpunimin mes universitetit tonë dhe Universitetit "G. d'Annunzio", duke konfirmuar vlerën e shtuar të programeve Erasmus+ si mjet për rritje reciproke dhe ndërkombëtarizim.

ZËRI I LETËRSISË NË KAMPUS

Një antologji që i jep
zë ëndrrave dhe fjalëve
të komunitetit tonë
universitar

Tetori, muaji i letërsisë troket për herë të parë ndryshe në Bibliotekën "Fr. Paolo Ruatti", aty ku dija ndërthuret me vizionet e së ardhmes, aty ku brezat i lënë stafetën njëri-tjetrit, aty ku ëndërrat shndërrohen në realitet, ku qahet e qeshet nga sukseset apo dështimet e provimeve ku shoqërizimi është oazi i krijuar dhe më i preferuar në korpusin universitar, aty ku slogani "Të mësosh sesi të mësosh" është strategjia e të nxënës në detin e madh të informacionit.

Kjo dinamikë e komunitetit tonë të përbashkët, me bisedat e lira pas orë të tëra në studim e në formimin e tyre akademik ka zbuluar talente në fusha të ndryshme të artit, pasione, dëshira dhe aftësi që duken sikur janë stivuar në sirtarin e kujtesës së viteve që ata lanë pas. Hera- herës biblioteka u ka dhënë jetë talenteve të tyre duke i konsideruar krenari dhe gjurmë historike.

Pikturat e shumë studentëve zbukurojnë ambjentet e bibliotekës sikurse shumë poezi të tyre i dhanë një tjetër ngjyrë jetës së bibliotekës, e cila është shpesh edhe skena e teatrit të vogël ku mblidhemi për të interpretuar vargjet e të rinjve.

Biblioteka sjell për herë të parë një nisëm të re kulturore dhe letrare duke promovuar krijimin e një antologjie me poezi dhe prozë e hapur për krijimet e studentëve, pedagogëve dhe gjithë stafit akademik të UKZKM. "Tetori i Letërsisë" nuk është vetëm një muaj aktivitete, por një ftesë për të rikthyer pasionin për fjalën e bukur, për të ndarë emocionin që na shoqëron në heshtje dhe për të krijuar ura mes brezave, mendimeve dhe shpirtave.



Ky projekt synon të krijojë një kënd kulture, një mundësi ku arti të jetë ura lidhëse mes brezave, disiplinave dhe përjetimeve. Kjo antologji nuk është thjesht një botim, është një dëshmi e jetës së brendshme, një pasqyrë e shpirtit krijues që endet në auditorë, zyrë e salla leximi.

Antologjia do të botohet në periudhën më të ngrohtë, atë të krishtlindjes dhe do të shpërndahet në një aktivitet të veçantë promovues ku autorët do të kenë mundësi të ndajnë krijimet e tyre me komunitetin universitar.

da Mimoza Agastra

Përgjegjëse e Bibliotekës "Fr. Paolo Ruatti" pranë UKZKM



TAKIMET E ARDHSHME

ZKM RUN

NJË INICIATIVË PËR STUDENTËT DHE STAFIN

Çdo të shtunë

9am

📍 Pista e "Mbretit Salomon"

Universiteti Katolik ZKM, Tiranë

Kampusi ynë universitar është edhe kulturor e sportiv. Pista e vrapimit që rrethon gjithë godinat e kampusit tonë universitar dhe spitalor është pikë takimi për të apasionuarit pas vrapit të lirë, secili në ritmin e tij. Kjo ide lindi nga dëshira për t'i bashkuar studentët në një mënyrë alternative duke përqafuar një sjellje gjithnjë e më popullore në Evropë, siç është një klub vrapimi..

Këtë të shtunë zhvilluam katër xhiro, 5 km gjithsej, por secili është i lirë të përshkojë aq sa dëshiron. Pas vrapimit kalojmë kohë së bashku, hamë mëngjesin, bisedojmë dhe e mbyllim duke folur mbi një plan stërvitjeve për ditët që vijnë.

Duam ta zhvillojmë më tej këtë klub në mënyrë që t'i japim identitet, si për shembull, duke bërë bluzat tona, duke udhëtuar në destinacione të ndryshme që shijohen duke qenë një grup. Atëherë ju presim të shtunën që vjen, ejani të vrapojmë rreth pistës së "Mbretit Solomon" në Kampusin Universitar dhe Spitalor ZKM, sillni me vete edhe miqtë tuaj.



Spitali Katolik
Zoja e Këshillit të Mirë
Përkushtuar Shëndetit Tënd



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

**PRIMO ANNO
DI VITA
DEL BAMBINO**
dalla teoria alla pratica

📅 21 Ottobre 2025

🕒 11:30

📍 Casa Rossa, Aula 11-12

Università Cattolica

"Nostra Signora del Buon Consiglio"

Tirana

Relatore:

Prof.ssa ANILA GODO

Medico Specialista
in Oncematologia pediatrica

Letto:

Dott.ssa ILSA KRAJA MULA

Medico specialista in Pediatria

**GIARDINO
DEI GIUSTI**



**ZGJIDH
TË DREJTIN
2026!**